



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Njoftim publik

Në Drejtorinë e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, është dorëzuar kërkesa nr. 05-015/2-109068/19, dt. 14.05.2019, e Sylë SYLA, pronar i një shtëpie banimi, përmes së cilës kërkohet të “emërtohen rrugët të cilat gjenden në ZK Bërmicë e Poshtme.

Agjencia Kadastrale e Kosovës i ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentet e rrugëve që shtrihen në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1.2., pika 1.2.2. dhe pika 1.2.3., Neni 7, pika 1, pika 2, pika 2.1., 2.2. 2.3. dhe pika 2.4., të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2012 të MMPH – së, i ka dhënë këtyre rrugëve të reja një kod të veçantë (kodi 10764 & kodi 10765) dhe ka bërë propozimin për emërtim të këtyre rrugëve.

Emrat e propozuar:

1. Rruga me kod 10764 “LUGINA E VJOSËS” – Toponim, shtrihet në qendër të Alpeve Shqiptare, në Rrethin e Tropojës.
2. Rruga me kod 10765 “LUGINA E VALBONËS” – Toponim, shtrihet në jug të Shqipërisë.

Komentet lidhur me këto propozime duhet të dorëzohen nga data 26.06.2019 deri më 09.07.2019, në E-mail adresën: urbaniz miprishtine@rks-gov.net

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/201 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ëeb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit.

